



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2812/Prot.

3

Laç më 03.07.2025

VENDIM

Nr. 16 datë 30.06.2025

“PËR

**MIRATIMIN E VAZHDIMIT TË PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI
PYJOR/KULLOSOR E CILA DO TI NËNSHTROHET PROCEDURAVE TË HEQJES
NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETIT MINERAR
NGA SHOQËRIA “AGHAK CARA” sh.p.k .**

Mbështetur në: Ligjin nr. 139/2015 datë 17. 12. 2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 8480 datë. 27. 05. 1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjin nr. 10304, date. 15. 07. 2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, në V.K.M nr:433 datë 08.06.2016.”Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe Kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Kumunave/Bashkive”. VKM nr.559 datë 29.07.2022 të ndryshuar “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien në shfrytzim /përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjor. VKM nr.888, date.27.12.2022 “Për rastet e dhenies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedura dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqes dhe paksimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre., si edhe bazuar në shkresën me nr. 2352 Prot date: 25. 03. 2025, të protokolluar pranë Bashkisë Kurbin me nr. 1547 Prot, date: 27. 03. 2025, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, dhe sipas relacionit të paraqitur nga Agjencia e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak.

VENDOSI;

1. Miratimin e vazhdimit të procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor të sipërfaqes prej 9.5 ha, që shtrihet në ngastrat me Nr. 49 = 1.08 ha, Nr. 52/a = 4.92 ha, Nr. 52/d = 2.56 ha, dhe Nr. 51/b = 0.94 ha, në ekonominë pyjorë Shëmbri –Brret, me qëllim zhvillimin e aktivitetit minerar nga Shoqëria “AGHAK CARA” sh.p.k.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Agjencia e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave në Bashkinë Kurbin.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë

> Agjencia e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave.

>Arkivit

Sekretari i Këshillit

Arber LEKA

Kryetare e Këshillit

Edlira LLESHI

